



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-04

Prokurori i Specializuar kundër Pjetër Shalës

Vendosi: Trupi Gjykues I

Gjykatëse Mapi Feld-Folia, Kryegjykatëse

Gjykatës Roland Dekers

Gjykatës Zhilber Biti

Gjykatës Vladimir Mikula, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 31 gusht 2023

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Vendimi i Tretë në lidhje me Heqjen e Redaktimeve ose Zbatimin e Redaktimeve
të Reja në Transkriptet e Seancave Gjyqësore dhe Riklasifikimin e Tyre**

me Shtojcën 1 konfidenciale

T'u njoftohet:

**Ushtruesit të Detyrës së Zëvendësprokurorit
të Specializuar**
Vard Ferdinandse

Mbrojtjes së të akuzuarit
Zhan-Lui Zhilisen

Zyrës Administrative
Fidelma Donlon

Mbrojtësit të viktimave
Sajmon Loz

TRUPI GJYKUES I (Trupi Gjykses) lëshon këtë vendim të tretë në lidhje me heqjen e redaktimeve ose zbatimin e redaktimeve të reja në transkriptet e seancave gjyqësore dhe riklasifikimin e tyre.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 15 maj 2023, Trupi Gjykses urdhëroi palët dhe Mbrojtësin e Viktimave që, pas përfundimit të secilit bllok dëshmish, të kryejnë në vijimësi rishikimin e transkripteve dhe të paraqesin një parashtrim të përbashkët nëse redaktimet ekzistuese mund të hiqen dhe/ose transkriptet mund të riklasifikohen si publike, me qëllim respektimin në të njëjtën kohë të parimit të publicitetit dhe masave mbrojtëse për dëshmitarët dhe viktimat.¹
2. Nga 30 maji 2023 deri më 6 qershor 2023, Trupi Gjykses dëgjoi dëshminë e TW4-01-shit, i cili përfiton nga masat mbrojtëse kundrejt publikut.² Gjithashtu, më 16 qershor, 26-27 qershor dhe 3-4 korrik 2023, Trupi Gjykses dëgjoi dëshmitë e dëshmitarëve ekspertë Zbinjek Dolejsi (Zbyněk Dolejší) (W04887), Marek Gasior (Marek Gasior) (W04826) dhe Uilliam Guduin (William Goodwin) (W04875).³
3. Më 12 qershor 2023, Trupi Gjykses udhëzoi Zyrën Administrative, në veçanti sidomos Zyrën për Mbrojtjen dhe Mbështetjen e Dëshmitarëve (ZMMD) të lidhet me palët dhe Mbrojtësin e Viktimave, që nëse dëshirojnë, të shtojnë në parashtrimet e përbashkëta paraqitur nga palët dhe Mbrojtësi i Viktimave

¹ KSC-BC-2020-04, F00510, Trupi Gjykses I, Urdhri i Dytë për Parashtrime në lidhje me Heqjen e Redaktimeve dhe/ose Riklasifikimin e Transkripteve të Seancave Gjyqësore, 15 maj 2023, publik, para. 5, 8.

² KSC-BC-2020-04, Transkripti i seancës, 30 maj 2023, konfidencial, f. 1365-1479; Transkripti i seancës, 31 maj 2023, konfidencial, f. 1480-1603; Transkripti i seancës, 2 qershor 2023, konfidencial, f. 1604-1728; Transkripti i seancës, 5 qershor 2023, konfidencial, f. 1729-1857; Transkripti i seancës, 6 qershor 2023, konfidencial, f. 1858-1942.

³ Transkripti i seancës, 16 qershor 2023, konfidencial, f. 1943-2025; Transkripti i seancës, 26 qershor 2023, konfidencial, f. 2026-2100; Transkripti i seancës, 27 qershor 2023, konfidencial, f. 2101-2142; Transkripti i seancës, 3 korrik 2023, konfidencial, f. 2157-2207; Transkripti i seancës, 4 korrik 2023, publik, f. 2208-2247.

propozimet e tyre për heqjen e redaktimeve dhe/ose riklasifikimin e transkripteve.⁴

4. Më 3 dhe 6 korrik 2023, palët, Mbrojtësi i Viktimave dhe ZMMD-ja paraqitën propozime të përbashkëta lidhur me zbatimin e redaktimeve të reja dhe/ose riklasifikimin e transkripteve të seancave gjyqësore të mbajtura midis 30 majit dhe 16 qershorit 2023 (Propozimi i Përbashkët i Parë)⁵ dhe midis 26 qershorit dhe 4 korrikut 2023 (Propozimi i Përbashkët i Dytë).⁶

II. PARASHTRIME

5. Palët, Mbrojtësi i Viktimave dhe ZMMD-ja propozojnë që transkriptet e seancave gjyqësore të mbajtura në seancë private në datat 30-31 maj, 2 dhe 6 qershor dhe 3 korrik 2023 të riklasifikohen si publike, në varësi të zbatimit të redaktimeve, aty ku është e nevojshme për mbrojtjen e identiteteve të dëshmitarëve dhe informacionit konfidencial në lidhje me ta.⁷ Gjithashtu, palët, Mbrojtësi i Viktimave dhe ZMMD-ja propozojnë një redaktim në transkriptin e seancës gjyqësore të 3 korrikut 2023 që u mbajt në seancë të hapur.⁸ Së fundi, për

⁴ KSC-BC-2020-04, F00541, Trupi Gjyqësor I, *Vendim mbi Heqjen e Redaktimeve ose Zbatimin e Redaktimeve të Reja në Transkriptet e Seancave Gjyqësore dhe Riklasifikimin e Tyre*, 12 qershor 2023, publik, para. 25, me Shtojcën 1, konfidenciale.

⁵ KSC-BC-2020-04, F00561, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Prokurorisë i Propozimit të Përbashkët për Heqjen e Redaktimeve për Periudhën nga 30 maji deri më 6 qershor 2023*, 3 korrik 2023, publik, me Shtojcën 1, konfidenciale. Trupi Gjyqësor vë në dukje se pavarësisht titullit të Propozimit të Përbashkët të Parë, parashtrimet e bëra në të nga palët, Mbrojtësi i Viktimave dhe ZMMD-ja kanë lidhje me seancën gjyqësore të 16 qershorit 2023.

⁶ KSC-BC-2020-04, F00568, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Prokurorisë i Propozimit të Përbashkët për Riklasifikimin e Transkripteve të Dëshmitarëve për Periudhën nga 26 qershori deri më 4 korrik 2023*, 6 korrik 2023, publik, me Shtojcën 1, konfidenciale.

⁷ Shtojca 1 e Propozimit të Përbashkët të Parë, f. 2-10; Shtojca 1 e Propozimit të Përbashkët të Dytë, f. 2-3.

⁸ Shtojca 1 e Propozimit të Përbashkët të Dytë, f. 2.

seancat gjyqësore të mbajtura në datat 5, 16 dhe 26-27 qershor 2023 dhe më 4 korrik 2023 nuk janë paraqitur propozime.⁹

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

6. Trupi Gjykses mbështetet në nenet 21(2), 23, 40(2), (4) dhe (6)(f) të Ligjit Nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (Ligji) dhe rregullat 80, 84(1) dhe 120 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (Rregullorja).

IV. ANALIZË

7. Trupi Gjykses rikujton se, sipas nenit 21(2) të Ligjit dhe në përputhje me masat mbrojtëse për dëshmitarët dhe viktimat të urdhëruara në bazë të nenit 23 të Ligjit, në përcaktimin e akuzave kundër tij, i akuzuari gëzon të drejtën për gjykim publik. Me qëllim respektimin e parimit të publicitetit dhe ruajtjen në të njëjtën kohë të masave mbrojtëse ekzistuese, Trupi Gjykses ka ushtruar detyrën e vet sipas rregullës 84(1) të Rregullores për rishikimin e transkripteve të seancave gjyqësore të mbajtura midis 30 majit dhe 4 korrikut 2023 dhe urdhëron riklasifikimin e tyre, sipas rastit, siç përcaktohet më poshtë.

8. Trupi Gjykses fillimisht do të shqyrtojë propozimet e palëve, të Mbrojtësit të Viktimave dhe ZMMD-së në lidhje me transkriptet e seancave gjyqësore të mbajtura në seancë të hapur, me të cilat faktikisht kërkohet zbatimi vetëm i një redaktimi të ri në transkriptin e seancës gjyqësore të 3 korrikut 2023. Së dyti, Trupi Gjykses do të trajtojë propozimet që lidhen me riklasifikimin si publike të disa pjesëve të transkripteve të seancave gjyqësore të mbajtura në seancë private dhe me zbatimin më pas në to të redaktimeve të mëtejshme. Për referim më të lehtë,

⁹ Propozimi i Përbashkët i Parë, para. 2; Propozimi i Përbashkët i Dytë, para. 2.

Trupi Gjykses do t'i rendisë propozimet e miratuara në një shtojcë bashkëlidhur këtij vendimi.

A. TRANSKRIPTET E SEANCËVE GJYQËSORE TË MBAJTURA NË SEANCË TË HAPUR

9. Trupi Gjykses vë në dukje se palët, Mbrojtësi i Viktimave dhe ZMMD-ja kërkojnë zbatimin e një redaktimi të ri në transkriptin e seancës gjyqësore të 3 korrikut 2023.¹⁰ Në këtë aspekt, Trupi Gjykses rikujton se pjesë të transkripteve të seancave të hapura, përfshirë materialet audio-video, janë tashmë të disponueshme për publikun dhe zbatimi i redaktimeve të reja përbën redaktim të transkripteve pas seancës.

10. Trupi Gjykses gjykon se ky propozim përputhet me qasjen e Trupit Gjykses ndaj mbrojtjes së dëshmitarëve dhe viktimave sipas nenit 23 të Ligjit dhe krijon drejtpeshimin e duhur midis të drejtave dhe interesave të ndryshme që rrezikohen, domethënë parimit të publicitetit në bazë të nenit 40(4) të Ligjit, të drejtës së të akuzuarit për seancë publike në bazë të nenit 21(2) të Ligjit dhe mbrojtjes së dëshmitarëve dhe viktimave në bazë të nenit 23 të Ligjit. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses miraton kërkesën e palëve, Mbrojtësit të Viktimave dhe ZMMD-së për zbatimin e redaktimit të kërkuar në transkriptin e seancës gjyqësore të 3 korrikut 2023.

11. Përveç redaktimit të lartpërmendur, Trupi Gjykses gjykon se për të siguruar mbrojtjen e dëshmitarëve, viktimave dhe informacionit konfidencial që mund të çojë në identifikimin e tyre, në transkriptet e seancave gjyqësore të 27 qershorit dhe 3 korrikut 2023 nevojiten redaktime shtesë.

12. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses: (i) autorizon zbatimin e redaktimeve pas seancës në përputhje me shtojcën e këtij vendimi; dhe (ii) udhëzon Zyrën Administrative të zbatojë redaktimet e reja në versionin e redaktuar publik të

¹⁰ Shtojca 1 e Propozimit të Përbashkët të Dytë, f. 2.

transkriptit në përputhje me udhëzimet në shtojcën e këtij vendimi. Redaktimet e autorizuara vlejnë njësoj për transkriptet në gjuhët shqipe dhe serbe.

13. Kur të zbatojë këtë vendim, Njësia e Administrimit të Gjykatës (NJAGJ) duhet t'i dorëzojë Kryegjykatëses së këtij Trupi Gjykses për miratim dhe nënshkrim vetëm një urdhër për redakte ku të përfshihen të gjitha redaktimet e zbatueshme pas seancës. Gjithashtu, NJAGJ-ja udhëzohet që të kontaktojë Trupin Gjykses nëse del ndonjë problem në zbatimin e këtij vendimi.

B. TRANSKRIPTET E SEANCAVE GJYQËSORE TË MBAJTURA NË SEANCË PRIVATE

14. Trupi Gjykses vë në dukje se palët, Mbrojtësi i Viktimave dhe ZMMD-ja pajtohen se pjesë të caktuara të transkripteve të seancave gjyqësore të mbajtura më 30-31 maj, 2 dhe më 6 qershor dhe 3 korrik 2023 mund të bëhen publike në varësi të zbatimit të redakteve.¹¹ Palët, Mbrojtësi i Viktimave dhe ZMMD-ja janë kryesisht të interesuar për redaktimin e: (i) informacionit personal të dëshmitarëve; (ii) pjesëve të dëshmimeve të dëshmitarëve që mund të çojnë më tej në identifikimin e tyre; dhe/ose (iii) identitetit të dëshmitarëve të tjerë të mbrojtur ose të personave të lidhur familjarisht ose në mënyra të tjera me ta.

15. Trupi Gjykses gjykon se propozimet e palëve, Mbrojtësit të Viktimave dhe ZMMD-së janë të përligjura dhe krijojnë drejtpeshimin e duhur midis të drejtave dhe interesave të ndryshme që rrezikohen. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses miraton kërkesat e palëve, Mbrojtësit të Viktimave dhe ZMMD-së për riklasifikimin si publike të pjesëve të transkripteve të seancave gjyqësore të mbajtura më 30-31 maj, 2 dhe 6 qershor dhe 3 korrik 2023, në varësi të zbatimit të redakteve të kërkuara. Megjithatë, Trupi Gjykses e gjykon të nevojshme që, për të siguruar mbrojtjen e dëshmitarëve, viktimave dhe informacionit konfidencial që lidhet me to, të zbatojë

¹¹ Shtojca 1 e Propozimit të Përbashkët të Parë, f. 2-10; Shtojca 1 e Propozimit të Përbashkët të Dytë, f. 2-3.

redaktime shtesë në pjesët e transkripteve që palët, Mbrojtësi i Viktimave dhe ZMMD-ja kërkojnë t'i riklasifikojnë si publike.

16. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses autorizon riklasifikimin si publike të pjesëve të transkripteve të seancave gjyqësore të lartpërmendura mbajtur në seancë private dhe zbatimin e redaktimeve të mëtejshme në to, në përputhje me shtojcën e këtij vendimi. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses udhëzon Zyrën Administrative të riklasifikojë si publike pjesë të transkripteve të seancave private në përputhje me udhëzimet në shtojcën e këtij vendimi dhe në varësi të zbatimit të redaktimeve të përmendura në të. Riklasifikimi i lartpërmendur i transkripteve dhe zbatimi i redaktimeve duhet të zbatohen njësoj për transkriptet në gjuhët shqipe dhe serbe.

C. MATERIALET AUDIO-VIDEO

17. Trupi Gjykses përfshin përmes referimit udhëzimet e tij të mëparshme për Zyrën Administrative në lidhje me zbatimin e redaktimeve të materialeve audio-video të transkripteve të seancave gjyqësore përkatëse.¹²

V. VENDIM

18. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykses:

- a) **AUTORIZON** zbatimin redaktimeve të reja pas seancës në versionet e redaktuara publike të transkripteve në përputhje me paragrafin 12 të këtij vendimi;
- b) **AUTORIZON** riklasifikimin si publike të pjesëve të transkripteve të seancave gjyqësore të mbajtura në seancë private dhe zbatimin më pas

¹² KSC-BC-2020-04, F00579, Trupi Gjykses I, *Vendimi i Dytë mbi Heqjen e Redaktimeve ose Zbatimin e Redaktimeve të Reja në Transkriptet e Seancave Gjyqësore dhe Riklasifikimin e Tyre*, 11 korrik 2023, publik, para. 24-25, me Shtojcën 1, konfidenciale.

në to të redaktimeve të mëtejshme në përputhje me paragrafin 16 të këtij vendimi;

- c) **UDHËZON** Zyrën Administrative të riklasifikojë si publike pjesët e transkripteve të seancave gjyqësore në të gjitha gjuhët në varësi të redaktimeve të autorizuara, siç përcaktohet në shtojcën e këtij vendimi;
- d) **UDHËZON** Administratoren të zbatojë redaktimet në transkriptet e seancave gjyqësore përkatëse, në të gjitha gjuhët, siç përcaktohet në shtojcën e këtij vendimi;
- e) **UDHËZON** Administratoren të zbatojë, për aq sa është teknikisht e mundshme, redaktimet në materialet gjegjëse audio-video të transkripteve të seancave gjyqësore përkatëse në të gjitha gjuhët; dhe
- f) **UDHËZON NJAGJ-në** që të kontaktojë Trupin Gjykses nëse del ndonjë problem në zbatimin e këtij vendimi.

_____/nënshkrimi/____

Gjykatëse Mapi Feld-Folia
Kryegjykatëse

_____/nënshkrimi/____

Gjykatës Zhilber Biti

_____/nënshkrimi/____

Gjykatës Roland Dekers

E enjte, 31 gusht 2023

Në Hagë, Holandë.